



**NIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe veterinarisë

**Departamenti:** Teknologji

Ushqimore me Bioteknologji

**Programi:** MSc Shkenca e Ushqimit

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Brikena Hulaj Krasniqi , me titull: **“Perceptimi i publikut mbi teknologjitë ushqimore ”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 05 deri me datë 12.12.2023.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. asoc. dr. Iliriana Miftari kryetare
2. Prof. asoc .dr. Arbenita Hasani mentore - anëtare,
3. Prof. asoc .dr. Salih Salihu anëtar,

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc.Dr. Arbenita Hasani, përmes e-mail adresës [arbenita.hasani@uni-pr.edu](mailto:arbenita.hasani@uni-pr.edu).

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sygjërim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

**DEPARTAMENTI SHKENCA E USHQIMIT**

**PROGRAMI SHKENCA E USHQIMIT**



Tema:

**“PERCEPTIMI I PUBLIKUT MBI TEKNOLOGJITË USHQIMORE”**

Mentor:

***Prof. Asoc. Dr Arbenita Hasani***

Kandidati:

***Bsc. Brikena Hulaj Krasniqi***

Prishtinë, 2023

## ABSTRAKTI

Studimi është kryer në vitin 2023 me anën e një pyetësi i cili është munduar të përfshijë të gjitha regjionet brenda territorit të Republikës së Kosovës përmes çashmërisë së tij edhe në formën online. Në këtë studim është prezantuar hulumtimi i perceptimit të produkteve ushqimore duke u bazuar në teknologjitë ushqimore të cilat kanë ndikuar në prodhimin e tyre. Njëkohësisht në këtë hulumtim është përfshirë edhe ajo se sa janë të informuar apo keqinformuar konsumatorët brenda Kosovës për teknologjitë e ndryshme ushqimore në zhvillim të cilat po shihen si teknologji të së ardhmes në uljen e urisë, prodhimin e produkteve të sigurta dhe cilësore me ç'rast do të arrihej një kënaqësi e konsumatorit . Duke pasur parasysh trendin e madh të rritjes së popullsisë në Botë problematika e sigurimit të ushqimit për këtë numër në rritje të banorëve paraqet një nga sfidat më të mëdha të hulumtuesëve dhe shkencëtarëve për të zbuluar dhe avancuar teknika të reja për prodhimin e ushqimit me teknologjitë e reja të cilat do të ndikojnë në uljen e shkallës së urisë dhe rritjen e vlerave ushqyese të produkteve. Motivi për të studiuar dhe analizuar perceptimin e publikut mbi teknologjitë e reja ushqimore vjen si pasojë e refuzimit të vazhdueshëm të qytetarëve për t'i përdorur produktet e prodhuara nga këto teknologji duke i cilësuar ato si të rrezikshme. Pyetësi ka qenë i ndërtuar nga dy pjesë ku në pjesën e parë kanë qenë pyetjet demografike duke përfshirë moshën, gjininë, statusin e punësimit, shkollimit etj., ndërsa në pjesën dytë ka pasur pyetje mbi njohuritë themelore dhe të hollësishme të konsumatorit për teknologjitë ushqimore në zhvillim.

Ndonëse pyetësi ka qenë i qasshëm për të gjitha grupmoshat në këtë pyetësor përqindja më e madhe 34.66% e tyre u takon grupmoshës 19-29 vjeç, të pasuar nga grupmosha 45-60 vjeç me 22.66%. Konsumatorët e përgjigjur në pyetësor në një përqindje më të madhe (22.66% respektivisht 31.3%) janë shprehur se kanë njohuri mesatare apo të pakta për teknologjitë e reja të prodhimit të cilat kanë marr një hov zhvillimi në këtë kohë. Si rezultat i mosnjohjes së këtyre teknologjive të reja në këtë pyetësor konsumatorët janë deklaruar se nuk i përdorin dhe i shmangin ushqimet e prodhuara si rezultat i këtyre teknologjive duke i cilësuar ato si të panatyrshme. Duke qenë të kujdesshëm dhe të frikësuar për shëndetin e tyre dhe cilësinë e ushqimeve të tyre konsumatorët në përqindje më të madhe 39.66% janë deklaruar se do të paguanin më shtrenjtë nëse kjo do tu garantonte atyre siguri dhe rritje të cilësisë së ushqimeve që ata i konsumojnë ndërsa 3.33% nuk pajtohen fare me këtë mendim. Sa i përket përdorimit të aditivëve në ushqim konsumatorët në përqindje më të madhe 27.33% janë deklaruar se i shohin aditivët si të nevojshëm dhe të sigurt nëse përdorimi i tyre bëhet në sasinë e duhur. Numri më i madh i konsumatorëve 47 % gjithashtu është përgjigjur se i besojnë plotësisht qeverisë dhe pajtohen me rolin e saj në sigurinë e ushqimit të tyre. Teknologjitë e reja ushqimore me një mesatare është vërejtur se 26.59% e konsumatorëve nuk do t'i përdornin me vetëdije, 25.73% i perceptojnë si të panatyrshme ndërsa 13.73% i konsiderojnë si të rrezikshme për shëndetin.

Fjalët kyçe: Teknologjitë e reja ushqimore, konsumatori, pranimi, refuzimi